



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:161023
Datë: 20.06.2024
Numri i dokumentit: 05842772

Ac.nr.9464/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci-kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi, dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve S.R., nga fshati Ll., E.R., nga fshati B., R.K, nga fshati Ll., R.M., nga fshati D.M., dhe A.B., nga Lipjani, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Sh.S., avokat në Lipjan, kundër të paditurës Komuna e Lipjanit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.K., për kompensim e mëditjeve, duke vendosur lidhur me ankesat e të autorizuarit të palës paditëse dhe palës së paditur të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, C.nr.506/2018, të datës 07.10.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditësve S.R., nga fshati Ll., E.R., nga fshati B., R.K., nga fshati Ll., R.M., nga fshati D.M., dhe A.B., nga Lipjani, dhe e të paditurës Komuna e Lipjanit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, C.nr.506/2018, i datës 07.10.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, me aktgjykimin e atakuar, C.nr.506/2018, të datës 07.10.2021, ka vendosur si në vijim: “I. Aprovohet pjesërisht kërkesëpadia paditëseve S.R. nga fshati Ll., E.R. nga fshati B., R.K. nga fshati Ll., R.M. nga fshati D.M. dhe A.B. nga Lipjani, si e bazuar, obligohet e paditura Komuna e Lipjanit, që në emër të pjesëmarrjes në seanca të mbajtura si anëtar i komitetit për planifikim dhe urbanizëm të Komunës së Lipjanit, për periodën prej datës 21.12.2015 e deri me 30.06.2016, të ua paguaj paditësve dhe atë paditësit S.R. nga fshati Ll., shumen prej 100,00.-€, për pjesëmarrje ne dy seanca të këtij komiteti, si dhe shumen prej 43.84.-€ ne emër të kamatës, E.R. nga fshati B., shumen prej 50,00.-€, për pjesëmarrje në një seance të këtij komiteti si dhe shumen prej 23,00.-€ në emër të kamatës, R.K. nga fshati Ll., shumen prej 100,00.-€, për pjesëmarrje në dy seanca të këtij komiteti si dhe shumen prej 43.84.-€ në emër të kamatës, R.M. nga fshati D.M. shumen prej 100,00.-€, për pjesëmarrje në dy seanca të këtij komiteti si dhe shumen prej 43.84.-€ në emër të kamatës, dhe A.B. nga Lipjani, shumen

prej 100,00.-€, për pjesëmarrje ne dy seanca të këtij komiteti si dhe shumen prej 43.84.-€ në emër të kamatës, të gjitha këto shuma me kamat vjetore prej 8%, duke filluar nga dt. 07.10.2021, e deri tek pagesa definitive. II. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësve S.R. nga fshati Ll., E.R. nga fshati B., R.K. nga fshati Ll., R.M. nga fshati D.M. dhe A.B. nga Lipjani, mbi shumat e gjykuara si ne al. I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, si e pabazuar. III. OBLIGOHET e paditura Komuna e Lipjanit, që paditësve tua kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 860.00 €, si dhe t'ua paguaj paditësve shumat nga al. I. i dispozitivit të këtij aktgjykimi, brenda afatit prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, me kërcenim të përmbarimit me dhunë”.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor kanë paraqitur ankesë:

I autorizuari i paditësve duke atakuar aktgjykimin në pikën II dhe III të dispozitivit, për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, të aprovon në tërësi ankesën e paditësve, të ndryshon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar, apo çështjen ta kthej në ri procedurë dhe rivendosje.

I autorizuari i të paditurës për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, të prishë aktgjykimin e atakuar C.nr.506/18, të datës 07.10.2021, dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje apo të vendos lidhur me këtë çështje juridike civile.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194, 195, dhe 200 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e paditësve dhe e të paditurës janë të pathemelta.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 21.12.2018, në gjykatën e shkallës së parë, kanë paraqitur padi kundër të paditurës, për kompensimin e mëditjeve. Në padi kanë parashtruar se paditësit posedojnë cilësinë e anëtarëve të Komitetit për Planifikim dhe Urbanizëm në kuadër të Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm Mbrojtje të Mjedisit, i cili komitet ishte themeluar nga Kuvendi Komunal i të paditurës në mbledhjen e datës 24.04.2014, dhe prej kësaj date paditësit i kanë ushtruar funksionet e tyre si anëtar dhe për çdo mbledhje të mbajtur nga ky komitet paditësve në cilësi të anëtarëve të komitetit i ka takuar kompensimi në emër të mëditjes të cilin kompensim nuk e ka bërë e paditura edhe pas parashtrimit të kërkesës për kompensim. Pas nxjerrjes së provës me ekspertizë financiare përmes parashtrësës së datës 22.09.2021, ka bërë precizimin e kërkesëpadiisë duke i propozuar gjykatës që të detyroj të paditurën që paditësve t'ia bëjë kompensimin e mëditjeve për pjesëmarrje në Komitetin për Planifikim dhe Urbanizëm të Komunës së Lipjanit, për periodën nga data 26.04.2014, deri me datë 30.06.2016, në shumat si në petitum të kësaj parashtrëse, së bashku me kamatën ligjore prej 8%, si t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës.

E paditura në përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësve duke i propozuar gjykatës që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata duke vepruar sipas padisë dhe kërkesëpadisë së precizuar të paditësve, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.506/2018, të datës 07.10.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjyimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjyimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar së në mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësit kanë qenë të zgjedhur anëtar të komitetit për planifikim dhe urbanizëm, dhe së kanë marrë pjese ne seanca të këtij komiteti, dhe se nuk janë kompensuar për pjesëmarrje në seanca të këtij komiteti. Tutje ka arsyetuar së në bazë të provave të administruara është vërtetuar së me vendimin për themelimin e komitetit për planifikim dhe urbanizëm 15 Nr.020-7730 te dt. 26.02.2014, Kuvendi Komunal i Lipjanit ka themeluar këtë komitet, në përbërje prej anëtarëve F.S., R.M., A.B., R.K., H.R., N.G., L.Rr., S.R. dhe E.R., dhe se paditësit nuk janë anëtar të kuvendit të komunës së Lipjanit, së të njëjtit në periodën prej 21.12.2015 e deri me 30.06.2016, kanë marre pjese në seanca të komitetit për Planifikim dhe Urbanizëm dhe atë S.R. ne dy seanca, E.R. ne një seancë, R.K. në dy seanca, R.M. në dy seanca, A.B. në dy seanca, se paditësve nuk u është kompensuar shpërblimi për pjesëmarrje në seanca të këtij komiteti, se paditësit i janë drejtuar me kërkesë të paditurës, për kompensim të kësaj kërkesë, por kërkesa e tyre nuk është miratuar nga e paditura, e bazuar në dispozitat e nenit 51 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 9 të Udhëzimit administrative nr.16/2008, të Qeveris së Republikës së Kosovës, gjykata ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve pjesërisht është e bazuar, dhe si të tillë e aprovoi pjesërisht, si ne al. I. të dispozitivit të aktgjykimi. Lartësinë e kërkesëpadisë se paditësve, gjykata e ka përcaktuar duke pasur parasysh mendimin dhe konstatimin e ekspertit gjyqësor G.B., të dhënë në ekspertizën e hartuar me shkrim të dt. 20.09.2021, dhe sqarimeve te dhëna ne seancën gjyqësore të dt. 07.10.2021, se cilës ekspertize gjykata ia fali besimin dhe e vlerësoi si ekspertize profesionale dhe të hartuar ne baze të rregullave të profesionit, sipas të cilës në periodën nga dt.21.12.2015 e deri me dt. 30.06.2016, bazuar në fletoren e të paditurës, ku janë mbajtur procesverbalet për seancat e mbajtura të këtij komiteti, paditësit S.R., R.K., R.M. dhe A.B. kanë marre pjese në dy seanca të komitetit për planifikim dhe urbanizëm, ndërsa E.R. ka marre pjese ne një seancë të këtij komiteti, ku për çdo seance të këtij komiteti u është llogaritur nga 50.00€, dhe u është aprovuar kërkesa prej nga 100,00.-€ paditësve S.R., R.K., R.M. dhe A.B., ndërsa paditësit E.R. në shumë prej 50,00 -€.

Lidhur me pjesën refuzuese të kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar së e ka refuzuar kërkesën e paditësve për kompensim në seancat e mbajtura te Komitetit për Planifikim dhe Urbanizëm, të mbajtura nga dt. 26.04.2014 e deri me 21.12.2015 për shkak të parashkrimit, për faktin se bazuar ne nenin 353.1 të LMD-së, me te cilën parashihet se ” kërkesat e dhënieve periodike qe rrjedhin vite për vit ose ne afatet e caktuara me te shkurtuara (kërkesat periodike) qofshin ato kërkesa periodike aksesore, siç janë kërkesat e kamatës, apo kërkesat periodike të atilla me të cilat përfundon vete e drejta, siç janë kërkesat e ushqimit, parashkruhen tri vjet nga arritje e secilës dhënie për pagese” dhe në dispozitën e nenit 87 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212

(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 90/01.12.2010) tek afati i parashkrimit, më të cilën parashihet se “te gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës”, kërkesa e paditësve para datës 21.12.2015, sipas vlerësimit të gjykatës është parashkruar, sepse kërkesa për pagese për pjesëmarrje në seanca janë para dt. 21.12.2015. dhe ka kaluar koha ma tepër se tri vjet nga dita kur paditësit e kanë ngritur padinë me dt.21.12.2018, prej të cilës kohe edhe është ndërprerë parashkrimi.

Lidhur me kamatën, gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitat e nenit 382 par.2 LMD-së, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit të Kosovës, nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor i paditësve dhe të paditurës së aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë dhe arsyetimi përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare, të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur lidhur me themelësinë e kërkesëpadsisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Gjykata në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ka paraqitur arsye mjaftueshme në lidhje me bazën e kërkesëpadsisë dhe lidhur me lartësinë e kërkesës së aprovuar, si dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme për pjesën e refuzuar të kërkesëpadsisë së paditësve.

Gjykata e Apelit vlerëson se janë të paqëndrueshme pretendimet ankimore të paditësve dhe të paditurës për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, sepse nuk ka qenë kontestuese së paditësit kanë qenë anëtar të komitetit për planifikim dhe urbanizëm të themeluar me vendimin 15Nr.020-7730, datë 26.02.2014, të Kuvendit të Komunës së Lipjanit, dhe së të njëjtit për periudhën nga data 21.12.2015 e deri me 30.06.2016, kanë marrë pjesë në seancat e mbajtura të këtij komiteti siç është konstatuar në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, i cili fakt është vërtetuar edhe në bazë të fletores së të paditurës ku janë mbajtur procesverbalet e seancave të komitetit për planifikim dhe urbanizëm. Po ashtu, përmes ekspertizës financiare të datës 20.09.2021, të përpiluar nga eksperti gjyqësor G.B., gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike sa i përket lartësisë së kërkesëpadsisë për pjesën e aprovuar, pasi që eksperti bazuar në detyrat e dhëna nga gjykata dhe bazuar në shkresat e lëndës ka bërë kalkulimin e shumave të cilat i takojnë paditësve për pjesëmarrjen në seancat e komitetit

për planifikim dhe urbanizëm, ku për pjesëmarrjen në një seancë është llogaritur shuma prej 50.00 euro, siç përcaktohet me nenin 9 të Udhëzimit Administrativ Nr.16/2008 për pagesën e stafit politik në komunë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka aplikuar të drejtën materiale, pasi që në bazë të nenin 9 të Udhëzimit Administrativ Nr.16/2008 për pagesën e stafit politik në komunë, i cili ka hyrë në fuqi me datë 05.09.2008, është paraparë së *“Anëtarët e komiteteve komunale që nuk janë edhe anëtarë të Kuvendit të Komunës, kompensohen më së shumti 50.00 (pesëdhjetë euro), për pjesëmarrje në çdo seancë, por jo të kompensohen me shumë së për 12 seanca në vit”*. Ndërsa në bazë të nenit 51 par.1 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, është paraparë së *“Kuvendet komunale themelojnë Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete si komitete të përhershme”*. Tutje paragrafi 2 i këtij neni përcakton së *“Kuvendi i komunës themelon komitete të tjera për të cilat konsideron se janë të nevojshme për kryerjen e përgjegjësisive të tyre”*. Në rastin konkret vendimin për themelimin e komitetit për planifikim dhe urbanizëm Kuvendi i Komunës së Lipjanit, e ka marrë duke u bazuar në dispozitën e lartcekur, andaj duke qenë së është vërtetuar së paditësit kanë qenë anëtarë të këtij komitetit dhe të njëjtit nuk kanë qenë anëtar të Kuvendit të Komunës, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ia ka njohur paditësve kompensimin në emër të pjesëmarrjes në këtë komitet për ditët e realizuar gjatë periudhës prej datës 21.12.2015 e deri me datë 30.06.2016, kjo bazuar në neni 9 të Udhëzimit Administrativ Nr.16/2008.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndron pretendimi i të paditurës së kompensimi për pjesëmarrje në komitete sipas udhëzimit administrativ të lartcekur i takon vetëm anëtarëve të dy komiteteve të përhershme, kjo pasi që në bazë të nenit 51 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Kuvendet Komunale përveç dy komiteteve të përhershme siç është Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete, kanë të drejtë që të themelojnë edhe komitete tjera për të cilat konsideron së janë të nevojshme për t'i kryer përgjegjësit e tyre, ndërsa neni 9 i Udhëzimit Administrativ Nr.16/2008 për pagesën e stafit politik në komunë, ku është rregulluar kompensimi i anëtarëve të jashtëm të komiteteve, nuk bënë dallim në mes të anëtarëve të komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera të krijuara bazuar në Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale. Përrjashtimi i vetëm është paraparë në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ Nr.16/2008 për pagesën e stafit politik në komunë, ku është paraparë së kompensimet e parashikuara në nenin 7, 8 dhe 9, të këtij udhëzimi nuk zbatohen për kryetarët dhe nënkryetarët e komunave, kryesuesit dhe zëvendës kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Gjykata e Apelit, e pranon përfundimin e gjykatës së shkallës së parë edhe sa i përket refuzimit të pjesshëm të kërkesës së paditësve, pasi që gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka vërtetuar faktin së kërkesa e paditësve për kompensimin e mëditjeve për pjesëmarrje në komitete për periudhën nga data 26.04.2014, deri me datë 20.12.2015, është parashkruar. Kjo bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, i cili parasheh së *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Po ashtu edhe në bazë të nenit 353 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve është paraparë së *“Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike), qofshin ato kërkesa periodike akcesore, siç janë kërkesat e kamatës, apo kërkesa*

periodike të atilla në të cilat përfundon vetë e drejta, siç janë kërkesat e ushqimit, parashkruhen tri (3) vjet nga arritja e secilës dhënie të veçantë për pagesë". Në rastin konkret paditësit kanë paraqitur padinë në gjykatë me datë 21.12.2018, ndërsa nga data 20.12.2015, e cila konsiderohet si datë e fundit e periudhës për të cilën është refuzuar kërkesa, e deri me datë 21.12.2018, kanë kaluar me tepër së tre vite, andaj duke qenë së e paditura është thirrur në parashkrim kjo gjykatë vlerëson së gjykata e shkallës së parë bazuar në dispozitat e lartcekura me të drejtë e ka refuzuar kërkesën e paditësve si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, pasi që kërkesa e paditësve për këtë periudhë është përfshirë në parashkrim.

Lidhur me pretendimin e të autorizuarit të paditësve së gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale kur e ka refuzuar kërkesën e paditësve për shkak të parashkrimit, pasi që sipas palës paditëse në këtë rast është dashur që të aplikohen dispozitat që rregullojnë afatin e parashkrimit për çështjet e pasurimit pabazë, Gjykata e Apelit, vlerëson së ky pretendim është i pabazuar pasi që në këtë rast nuk kemi të bëjmë me pasurim pabazë siç përcaktohet me nenin 194 të LMD-së, por kërkesa e paditësve ka të bëjë me kompensimin e mëditjeve për pjesëmarrje në komitete komunale bazuar në Udhëzimit Administrativ Nr.16/2008 për pagesën e stafit politik në komunë, ku është e rregulluar edhe lartësia e kompensimit. Prandaj, gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale kur ka vendosur për refuzimin e pjesës së kërkesëpadisë së paditësve për shkak të parashkrimit bazuar në dispozitat e lartcekura.

Vendimi mbi kamatën ligjore është në përputhje me dispozitën e nenin 382 par.2 të LMD-së, ashtu që gjykata e shkallës së parë i ka njohur paditësve kamatën e arritur e cila është llogaritur në ekspertizën financiare, ndërsa për periudhën pas marrjes së aktgjykimit datë 07.10.2021, e deri në pagesën definitive, ka gjykuar kamatën vjetore prej 8%, e cila duhet të llogaritet në borxhin kryesor.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është vlerësuar se është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, dhe në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë se shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e nenit e neni 449, 452 dhe 463 të LPK-së, pasi që shumta e cila i është aprovuar secilit paditës veç e veç nuk e kalon shumën prej 500.00 euro, e cila llogaritet si vlerë e kontestit të vogël.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi të gjitha pretendimet tjera ankimore të palëve ankuese, por që nuk kishin ndikim për të vendosur ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.9464/2021, datë 10.06.2024

Kryetar i kolegjit, Gjyqtari
Hysni Bardheci